



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:227652

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05743523

2023:229810

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Pergjithshem-Divizioni Penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me bashkëpunëtorin profesional Ismanj Kuçi në çeshtjen penale ndaj të pandehurit M.K nga fsh....-Kaçanik, i akuzuar për veprën penale, Vjedhje pylli nga neni 349 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/IL.nr.1529/23 të datës 25.10.2023 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.02.05.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Mimoza Sylja-Hyseni, përfaqësuesit të dëmtuarës, A. L. dhe të pandehurit, me dt.03.05.2024 mori dhe shpalli, ndërsa me datë 27.05.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri M.K nga fsh. ... Komuna Kaçanik, i lindur më dt.... , nga i ati I.. dhe e ëma H., e gjinisë V... , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor privat, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal: ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 03.10.2023, rreth orës 14:00h, në pyllin publik, të cilin e menaxhon Drejtoria për Bujqësi Zhvillim Rural dhe Pylltari Komuna - Kaçanik, saktësisht në vendin e quajtur “Kodra e Kuqe”, me qëllim vjedhje me sharrë motorike ka prerë 60 copë drunjë të njoma, të llojit të bungut me diametër 10-14 cm, në lartësi 7 m, në vëllim të përgjithshëm prej 2.10 m³, duke i shkaktuar dëm të DBZHR-së, në vlerë prej 283.50 €.

Me çka ka kryer veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr. 06/L-074.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 2,7,38,43,69,70,71 par.1 nenpar.1.3 të KPRK-së, nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 450.00 € (katërqind e pesëdhjetë euro), të cilën është i obliguar që t’a paguajë ne afatin prej 30 ditësh, por jo më shumë se dy muaj pas pas plotfuqishmerise së këtij aktgjykimi, dhe atë në tri këste.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën, gjykata do t’a zëvendesoje dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumën prej 20 € për çdo ditë burgimi.

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës, të paguajë pranë kësaj gjykate, shumën prej 20.00€, në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 30€, ndërsa në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 20.00€, në afat të njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Obligohet i pandehuri, që të dëmtuarës DBZHRP-Komuna Kaçanik, t’i kompenzojë dëmin në vlerë prej 283.50 €.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1529/23 të datës 25.10.2023 të pandehurin M.K nga ...-Kaçanik, e ka akuzuar për veprën penale, Vjedhje pylli nga neni 349 par.1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që I njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Ne bazë të kësaj aktakuze gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.25.01.2024 me te cilin rast, I pandehuri , pas prezentimit te aktakuzës nga prokurori I shtetit, nuk e ka pranuar plotësisht fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Ne shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më 02.05.2024, prokurorja e shtetit Mimoza Sylja-Hyseni , me rastin e prezentimit të aktakuzës, deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës, pa ndryshime dhe plotësime.

Përfaqësuesi I autorizuar I të dëmtuarës Agim Luzha, në fjalën e tij në shqyrtim gjyqësor, I bashkangjitet ndjekjes penale dhe parashtron kërkesë pasurore juridike.

I pandehuri në fjalën e tij në shqyrtimin gjyqësor, e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, duke shtuar se në kohën për të cilën bëhet fjalë, për shkak të gjendjes së dobët ekonomike, kishte shku në mal për të marrë drunj, për të plotësuar nevojat e ekonomisë familjare, mirëpo tani ka gati një vjet që nuk shkon në mal për të marrë drunj, dhe I premtion gjykatës se as në të ardhmen nuk do të përsërisë këso veprime, prandaj edhe I kërkon gjykatës, që me rastin e marrjes së vendimit, t'i shqiptohet një dënim sa më i ulët që të jetë e mundur.

Prokurorja e shtetit dhe përfaqësuesi I të dëmtuarës, nuk e kanë kundërshtuar pranimin e fajesise nga ana e të pandehurit.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 322 lidhur me 242 të KPP-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajesisë, se pranimi i fajesise është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbeshtetet ne faktet e çeshtjes qe permban akuza, se akti akuzues nuk permban asnje shkelje te qartë ligjore apo gabime teknike andaj shqyrtimin gjyqësor e vazhdoi pa administrimin e provave tjera.

Prokurorja e shtetit ne fjalën e saj përfundimtare deklaroi se, nga vetë pranimi I fajësisë nga ana e të pandehurit, i cili vullnetarisht e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet ne barrë

sipas aktakuzës, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv, andaj edhe i propozon gjykatës që të pandehurin t'a shpall fajtor dhe t'I shqiptojë sanksion penal sipas ligjit, duke patur parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethanë rënduese, intensitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur. Me fjalën përfundimtare të prokurores, pajtohet edhe përfaqësuesi I të dëmtuarës.

I pandehuri në fjalën e tij përfundimtare, deklaroi se mbetet pranë asaj që e ka thënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, me rastin e deklaramit lidhur me fajësinë.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit, manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Vjedhje pylli nga neni 349 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, konform nenit 70 të KPRK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në seancën e parë të shqyrtimit gjyqësor, ka premtuar para gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, ndërsa si rrethanë të posaçme rënduese gjykata gjeti faktin se, bazuar në evidencën e gjykatës i njëjti ka patur raste të tjera penale, për të cilat është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë, dhe kryesisht për veprën penale, Vjedhje pylli.

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin M.K, i akuzuar për veprën penale, Vjedhje pylli nga neni 349 par.1 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë tek i pandehuri dhe personat tjerë që të shmangen nga kryerja e veprave penale, dhe të forcojë detyrimin për respektimin e ligjit, dhe me këtë edhe të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore jurididike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEGA KAÇANIK
2023:229810 datë 27.05.2024

Bashkëpunëtori profesioanl
Ismajl Kuçi

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.